

Akademia e OJFve

Aftësi - Profesionalizëm - Zhvillim

Panoramë e Përgjithshme

Panoramë e Përgjithshme

Organizatat jo fitimprurëse (OJF-të) në Shqipëri operojnë në një mjedis shumë dinamik dhe luajnë një rol domethënës në zhvillimin e vendit, përmes shtrirjes së veprimtarisë në shumë fusha si dhe aftësive të ndryshme që zotërojnë. Në dy dekadat e fundit, sektori i OJF-ve në Shqipëri është rritur në numër dhe manaxhon burime të konsiderueshme financiare.

Megjithë eksperiencën e fituar, OJF-të kanë ende nevojë për të zhvilluar aftësi që lidhen me manaxhimin dhe zhvillimin organizativ, qëndrueshmërinë, mobilizimin e mbështetësve për të ndërtuar fushata advokacie dhe lobimi etj.

Sektori ka nevojë të njohë dhe kuptojë kuadrin ligjor dhe fiskal në lidhje me funksionimin e tij, marrëdhëniet me shtetin, të përmirësojë veprimet e koordinuara për një pjesëmarrje efektive në vendimmarrje dhe politikëbërje, të ndërtojë identitetin dhe imazhin e tij si aktor ndryshimi dhe kontribues në zhvillimin e vendit.

Roli i organizatave jofitimprurëse si promotorë të ndryshimit, varet në maturinë, kompetencën, përgatitjen dhe kapacitetet e tyre për të bashkëpunuar me sukses me partnerë strategjikë në vend.

Duke synuar të ngushtojmë hendekun midis njohurive dhe aftësive të nevojshme për sa më sipër, Partnerët Shqipëri lancoi për herë të parë në vitin 2015, **Akademinë e OJF-ve**, një program i cili ofron mundësi edukimi dhe zhvillimi për drejtuesit e OJF-ve shqiptare.

Përmes një qasje bashkëkohore të të mësuarit dhe një eksperience shumëdimensionale shkëmbimi përvojash, "Akademia e OJF-ve 2015" ofroi për 17 drejtues të OJF-ve nga i gjithë vendi, mundësi të mira për zhvillimin e njohurive dhe aftësive, për bashkëpunim, rrjetëzim dhe partneritet me organizata të ngjashme në vend dhe jashtë tij.

Në vijim të eksperiencës së suksesshme të vitit të kaluar, Partnerët Shqipëri ka kënaqësinë të njoftojë hapjen e **"Akademisë së OJF-ve 2016"**!

Akademia e OJF-ve:

- Shërben si hapësirë e edukimit jo-formal për të përforcuar aftësitë dhe zhvilluar kompetencat e drejtuesve të OJF-ve;
- Rrit profesionalizmin e këtyre drejtuesve nëpërmjet një kurrikule unike, metodave më bashkëkohore të të nxënimit si dhe përvojës profesionale shumëdimensionale;
- Kontribon për krijimin e brezave të drejtuesve profesionistë e të angazhuar, që do të jenë aktorë të ndryshimit dhe kontribues në zhvillimin e shoqërisë shqiptare.

Aplikimi

Aplikimi

Akademia është e hapur për drejtues të OJF-ve shqiptare që synojnë rritjen e aftësive dhe zhvillimin e tyre profesional në këtë sektor për të ndërtuar organizata efektive në shërbim të publikut dhe grupeve të interesit.

Kandidatët e interesuar për Akademinë 2016 janë të ftuar të aplikojnë duke plotësuar Formën e Aplikimit:

http://www.partnersalbania.org/Forma_Aplikimit_Akademia_OJFve2016.docx

Afati i fundit për dorëzimin e formës së aplikimit është **29 shkurt 2016**, ora 17.00

Kriteret dhe Procesi i Përzgjedhjes

Kriteret dhe Procesi i Përzgjedhjes

Akademia e OJF-ve 2016 është e hapur për drejtuesit e OJF-ve në pozicionin e Drejtorit të Organizatës apo Kryetarit të Bordit/ Kryesisë. Akademia do të mundësojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të sektorit me një shpërndarje të gjerë gjeografike dhe përfaqësim divers nënsektorial.

Një pjesë e programit planifikohet të jetë në gjuhën angleze. Përdorimi i literaturës dhe rasteve studimore do të kërkojë nivel të mirë njohjeje dhe përdorimi të gjuhës angleze.

Për vitin 2016 do të zgjidhen 30 pjesëmarrës!

Kriteret

Kandidatët do të përzgjidhen bazuar në:

- Motivimin për ndjekjen e Akademisë;
- Lidhjen ndërmjet rritjes individuale profesionale dhe zhvillimit të organizatës që drejtojnë;
- Angazhimin për të ndjekur të plotë programin e Akademisë dhe kryerjen e të gjitha aktiviteteve si pjesë e tij;
- Njohjen dhe përdorimin e gjuhës Angleze.

Procesi

- Të gjithë të interesuarit duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë Formën e Aplikimit brenda datës 29 shkurt 2016.
- Kandidatet e përzgjedhur do të njoftohen brenda datës 10 mars 2016. Vetëm aplikantët e përzgjedhur do të kontaktohen.
- Kandidatët e përzgjedhur do të vlerësohen mbi nivelin e njohjes së gjuhës angleze para konfirmimit si pjesëmarrës në Akademi.

Programi Programi

Sesionet	Kurrikula
Sesioni I	Hapja e Akademisë, Tendencat e zhvillimit të sektorit të shoqërisë civile dhe kuadri ligjor për sektorin
Sesioni II	Zhvillimi Organizativ dhe Qeverisja e Organizatave, Manaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Procedurat e Brendshme
Sesioni III	Manaxhimi Financiar - Buxhetimi dhe Kontabiliteti - Detyrimet dhe raportimet në shtet
Sesioni IV	Sigurimi i mbështetjes publike dhe puna me sektorin e biznesit. Ngritja e Fondeve dhe Filantropia
Sesioni V	Sigurimi i mbështetjes financiare përmes granteve. Shkrimi i projekt-propozimeve dhe manaxhimi i projekteve, grantet e BE
Sesioni VI	Komunikimi strategjik për OJF-të
Sesioni VII	Modelet e proceseve me pjesëmarrje. Qeverisja me pjesëmarrje
Sesioni VIII	Mobilizimi i mbështetësve, bashkëpunimi sektorial dhe ndërsektorial, rrjetëzimi
Sesioni IX	Advokacia dhe Lobimi
Sesioni X	Planifikimi Strategjik i OJF-ve
	Vizitë Studimore në Sllovaki - Kjo vizitë do të organizohet në bashkëpunim me Partnerët Sllovaki, për të ndarë praktikat më të mira, arritjet e sektorit, sfidat e bashkëpunimit ndërsektorial etj.
	Ceremonia e diplomimit

Programi i Akademisë do të zhvillohet nga muaji mars deri në nëntor, me një ndërprerje gjatë periudhës korrik-gusht. Çdo muaj do të zhvillohen dy sesione.

Për informacione shtesë, luteni të kontaktoni
Jonida Alite, Drejtore e Trajnimeve
email: jalite@partnersalbania.org

Shënim: POLITIKA JODISKRIMINUESE E PRANIMEVE NË AKADEMI

Në përzgjedhjen e pjesëmarrësve Partnerët Shqipëri do të udhëhiqet nga parimi i mosdiskriminimit mbi baza gjinore, fetare, etnie apo orientimi seksual.



Akademia e Partnerëve Shqipëri për OJF-të mbështetet nga Olof Palme International Center me fonde të Qeverisë Suedeze, dhe SlovakAid-Asistenca Zyrtare për Zhvillim e Republikës së Sllovakisë.